



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:183487

Datë: 09.11.2020

Numri i dokumentit: 01253799

C.nr.305/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin e vetëm gjykues Binak Duqi dhe zyrtaren ligjore Dalina Kërçeli, duke vendosur në çështjen civilo – juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Xh. (Rr.) G. nga fshati D., Komuna e P., për rimbursim i borxhit, vlera e kontestit 1506.00 euro, jashtë seance me dt.09.11.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa Shqyrtim Kryesor Të Çështjes-

I. APROVOHET në tersi **SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri Xh. (Rr.) G. nga fshati D., Komuna e P., që paditëses në emër të rimbursimit borxhit të shkaktuar të dëmtuarës në aksidentin e dt.09.03.2014, në shumën prej 1506.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive. Shumën e aprovuar i padituri detyrohet t’ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate për rimbursim borxhi, kundër të paditurit Xh. (Rr.) G. nga fshati D., Komuna e P.. Në padi thuhet se i padituri me dt.09.03.2014, në ora 22:25, ku sipas raportit policor, deri te aksidenti ka ardhur përderisa automjeti “A” me targë (i siguruar në “S.”) i cili ka dalë nga rruga dytësore me rrugën me përparësi kalimi pa e respektuar shenjën stop ka goditur veturën “B” e cila ishte në rrugën me përparësi kalimi.

Palët e dëmtuara F. L. (për dëmin në automjet), Z. L. dhe Ç. L. nga P., pranë paditëses kanë paraqitur kërkesë për kompensim dëmi material dhe jo material, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, palët ndërgjyqjese kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore me palën e

dëmtuar është aprovuar që të dëmtuarve, paditësja u ka kompensuar dëmin në lartësi prej 1506.00 euro totali i përgjithshëm.

Duke u mbështetur në rregullativën në fuqi paditësja ka qenë e obliguar që të përmbushë detyrimin ndaj palës së dëmtuar, duke i kompensuar dëmin e shkaktuar nga i siguruari i saj. Bazuar në dispozitat ligjore të LMD-së së vitit 2013 përkatësisht nenin 960 është përcaktuar se: “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit, kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin“ dhe e cila e drejtë fitohet në bazë Dispozitave ligjore të LSDA 2011 të nenit 18.1 dhe 4.

Prandaj në emër të rimbursimit të dëmit kërkon nga i padituri t’ia kompensoj shumën prej 1506.00 euro. Për këtë shkresave të lëndës i kemi bashkangjitur prova të mjaftueshme për pagesën e bërë.

I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tersi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin t’ia kompensoj shumën e kërkuar të cilën deri më sot nuk ia ka paguar edhe pse ka kërkuar prej tij me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri me anë të përgjigjes në padi me dt.26.10.2020 ka deklaruar ju njoftojmë se i padituri Xhevat Gashi ka poseduar polisë të sigurimit të cilin e ka paguar dhe siguruar te e paditura. Rrjedhimisht derisa e ka paguar sigurimin dhe me vetë dëshirë paditësi e ka siguruar, atëherë edhe e merr përgjegjësin për dëmet eventuale. Nuk ka kuptim që edhe të paguhet sigurimi edhe të i paguaj dëmet vet rrjedh pyetja pse i padituri e ka paguar sigurimin apo çfarë ka mbuluar polisa e sigurimit. Lidhur me atë se nuk ka pasur patentë shofer e paditura është dashur ta njoftojë paditësin me rastin e sigurimit të tij ose të mos e siguroj fare, në të kundërtën e merr përsipër mbulimin e dëmit. Andaj, kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i LPK – së, me të cilin përcaktohet se: “Po qe se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore të jep aktgjykim”, lidhur me nenin 143 të LPK-së, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e padituri e ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nuk qëndron kundërshtimi i paditurit se paditësja nuk ka të drejtë të kërkoj kompensimin e dëmit material dhe jo material sepse kjo është e rregulluar me Ligjin 04/L-018-LSDA (Ligji për sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia).

Andaj gjykata konform nenit 152 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të LMD-së së vitit 2013 përkatësisht neni 245 par.1 ku thuhet se: “Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tersi në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Kamatë vonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382.2 të LMD-së së vitit 2013. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mor konform nenit 450 të LPK-së me ç’rast secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale pasi që pala paditëse e ka paguar taksën për padinë e ushtruar në gjykatë në shumën prej 40euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.305/2017, dt.09.11.2020**

**Gjyqtari
Binak Duqi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.